

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar”
ORGANI UDHËHEQËS	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Projektakti nuk synon përafrimin e ndonjë direktive.
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Nuk aplikohet.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	13/02/2026 – 13/03/2026 https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/933
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	25/03/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po, 09/03/2026 Data e shqyrtimit
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – MTKS – Nr. 1
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Doris Hamzi Doris.Hamzi@mtks.gov.al Eliverta Vraniçi Eliverta.Vranici@mtks.gov.al
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	
<i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë?</i>	
<p>Problematika kryesore lidhet me organizimin institucional dhe varësinë administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA), e cila aktualisht ndodhet në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit sipas ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar”. Ky model organizimi ka krijuar disa problematika: së pari, një nivel të lartë centralizimi të administratës publike qendrore, ku rreth 26 autoritete dhe agjenci raportojnë drejtpërdrejt pranë Kryeministrit, duke rritur ngarkesën administrative dhe koordinuese të qendrës së qeverisjes dhe duke kufizuar shpërndarjen e balancuar të përgjegjësisë. Së dyti, ekziston një mospërputhje ndërmjet natyrës sektoriale të funksioneve të DPA dhe mbikëqyrjes institucionale, pasi funksionet e institucionit lidhen drejtpërdrejt me fushën e arkivave dhe koordinimin sektorial, por nuk menaxhohen nga ministria përkatëse, duke kufizuar integrimin dhe koordinimin e politikave sektoriale. Së treti, ka një nevojë për rishpërndarje më të</p>	

balancuar të përgjegjësive në administratën publike qendrore, duke reflektuar praktikat ndërkombëtare dhe rekomandimet e Raportit të SIGMA-s për forcimin e qendrës së qeverisjes, që thekson fokusimin e qendrës së qeverisjes në funksione strategjike dhe të koordinuara ndërsektorialisht, ndërsa funksionet sektoriale duhet të menaxhohen nga ministritë përkatëse.

Shkaqet e kësaj problematike lidhen kryesisht me rregullimin aktual ligjor, i cili përcakton varësinë institucionale të DPA nga Kryeministri, dhe me mungesën e një rishikimi sistematik të varësisë institucionale në përputhje me funksionet sektoriale që institucionet kryejnë. Përqendrimi i një numri të madh institucionesh në varësi të drejtpërdrejtë të qendrës së qeverisjes ka sjellë një ngarkesë të konsiderueshme për Kryeministrinë, kufizuar koordinimin sektorial dhe ka bërë që DPA të mos pasqyrojë plotësisht natyrën e veprimtarisë së tij sektoriale.

Grupet kryesore të prekura nga kjo problematikë përfshijnë Kryeministrinë, si institucion me përgjegjësi të drejtpërdrejtë mbikëqyrëse; ministrinë përkatëse, e cila ka koordinim më të tërthortë; vetë DPA, e cila ndikohet drejtpërdrejt nga mënyra e raportimit dhe mbikëqyrjes; institucionet publike dhe aktorët tjerë që përdorin fond arkivor, të cilët preken në mënyrë të tërthortë nga organizimi institucional i koordinimit dhe menaxhimit të të dhënave.

Në këtë kontekst, ndërhyrja e propozuar, duke rishikuar varësinë institucionale të DPA, synon të përmirësojë koordinimin institucional, të ulë centralizimin dhe të sigurojë një shpërndarje më të balancuar të përgjegjësive në administratën publike qendrore, duke e bërë sistemin më efikas dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të qeverisjes.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit?

Objektivi kryesor i ndërhyrjes është:

1. Përmirësimi i organizimit institucional të administratës publike qendrore, nëpërmjet rishikimit të varësisë institucionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA), brenda vitit 2026.

Ky objektivi synon të adresojë nivelin e lartë të centralizimit të institucioneve në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit dhe të kontribuojë në rishpërndarjen më të balancuar të përgjegjësive në nivel qendror, në përputhje me rekomandimet e Raportit të SIGMA-s të realizuar në kuadër të programit të OECD.

Objektivi është specifik pasi lidhet drejtpërdrejt me ndryshimin e varësisë institucionale të DPA-së. Ai është i matshëm, i arritshëm dhe realist, pasi ndërhyrja është e kufizuar dhe e natyrës organizative, pa kërkuar ndryshime në strukturën apo buxhetin e institucionit.

2. Ulja e nivelit të centralizimit të institucioneve që raportojnë drejtpërdrejt pranë Kryeministrit, nëpërmjet rishpërndarjes më të balancuar të përgjegjësive institucionale në administratën publike qendrore, brenda vitit 2026;
3. Sigurimi i përputhjes ndërmjet funksioneve sektoriale të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA) dhe mbikëqyrjes së tij institucionale, nëpërmjet vendosjes së këtij institucioni në varësi të ministrisë përgjegjëse për kulturën;

4. Forcimi i koordinimit ndërinstitutional dhe integritet të politikave në fushën e arkivave, nëpërmjet vendosjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA) nën mbikëqyrjen e ministrisë përgjegjëse për kulturën ;
5. Përmbushja e rekomandimeve të Raportit të SIGMA-s, duke forcuar koordinimin dhe shpërndarjen e përgjegjësiwe institucionale të DPA dhe duke përmirësuar efektivitetin e raportimit dhe mbikëqyrjes sektoriale brenda vitit 2026.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme.

Në kuadër të trajtimit të problematikës së identifikuar, janë shqyrtuar katër opsione politike për organizimin institucional të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA).

Opsioni 0, status quo, parashikon ruajtjen e situatës aktuale me DPA në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit, duke shmangur ndërhyrje ligjore dhe kosto shtesë, por nuk adreson problematikën e centralizimit dhe mungesës së përputhshmërisë ndërmjet funksioneve sektoriale dhe mbikëqyrjes institucionale.

Opsioni 1, ndryshimi i ligjit nr. 9154/2003, i ndryshuar është opsioni i preferuar dhe synon kalimin e varësisë institucionale të DPA nga Kryeministri tek ministri përgjegjës për fushën përkatëse. Ky opsion përmirëson koordinimin institucional, rrit përputhshmërinë ndërmjet funksioneve sektoriale dhe mbikëqyrjes, kontribuon në rishpërndarjen më të balancuar të përgjegjësiwe në administratën qendrore, kërkon më pak kohë dhe burime krahasuar me opsionin 2 dhe ndërhyrjet në varësinë institucionale pa prekur më shumë se 50% të dispozitave të ligjit, duke e bërë atë zgjidhjen më efikase dhe të realizueshme.

Opsioni 2, riorganizim më i gjerë institucional, parashikon hartimin e një ligji të ri me ndryshime të thella ligjore dhe strukturore, duke adresuar problematikën në mënyrë gjithëpërfshirëse, por kërkon kohë të gjatë, shpenzime të mëdha dhe burime të shtuar për menaxhimin e tranzicionit.

Opsioni 3, jorregullator, përfshin masa jo-ligjore për përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitutional, por është i gjatë në zbatim, kërkon shumë burime dhe nuk garanton adresimin e rrënjësishëm të problematikës.

Bazuar në analizën e kryer, opsioni i preferuar është ndryshimi i ligjit, pasi siguron ndërhyrje proporcionale, përputhet me rekomandimet e Raportit të SIGMA-s dhe adreson drejtpërdrejt sfidat e centralizimit institucional, pa kërkuar riorganizime komplekse apo kosto shtesë.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura.

Ndërhyrja në ligjin nr. 9154/2003, i ndryshuar ka për qëllim ndryshimin e varësisë institucionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA) nga Kryeministri tek Ministria përgjegjëse për fushën përkatëse.

Grupet kryesore të prekura janë: Kryeministria, Ministria e përgjegjësive sektoriale, DPA, institucionet publike që bashkëpunojnë me DPA në kuadër të ruajtjes dhe përdorimit të fondit arkivor.

Ndikimet kryesore ndahen në tre kategori:

Sociale: Përmirësohet koordinimi ndërinstitucional, qartësia e linjave të raportimit dhe mbikëqyrjes institucionale, rritet transparenca dhe përgjegjësia sektoriale, dhe zvogëlohet ngarkesa administrative e Kryeministrit.

Ekonomike: Ndikimet e drejtpërdrejta janë minimale, pasi nuk ndryshojnë struktura apo kompetencat, ndërsa ndikimet indirekte lidhen me përdorimin më efikas të të dhënave arkivore në projekte dhe shërbime.

Financiare: Nuk ka kosto financiare të drejtpërdrejtë, pasi ndërhyrja është ligjore dhe nuk kërkon buxhet shtesë.

Afatshkurtër dhe afatgjatë: Në afat të shkurtër, ndikimet lidhen me përshtatjen e praktikave të raportimit dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional. Në afat të gjatë, ndërhyrja pritet të rrisë efikasitetin e qeverisjes qendrore, të përmirësojë koordinimin midis institucioneve dhe të mbështesë zbatimin e politikave publike në mënyrë më efektive.

Analiza bazohet në supozimin se ndryshimi i varësisë institucionale nuk do të ndikojë në strukturën, buxhetin apo kompetencat e DPA. Provat mbështeten në gjetjet dhe rekomandimet e Raportit të SIGMA-s dhe përvojat ndërkombëtare të organizimit institucional.

Rreziqet kryesore lidhen me nevojën për përshtatje administrative gjatë fazës fillestare të tranzicionit dhe mundësi pengesash burokratike ose mungesë koordinimi.

Ndikimet kryesore janë institucionale dhe administrative, ndërsa ndryshimi i propozuar konsiderohet efektiv dhe i përputhshëm me rekomandimet ndërkombëtare, duke rritur efikasitetin, koordinimin dhe transparencën pa sjellë kosto financiare ose ndryshime strukturore.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni i preferuar është përzgjedhur **Opsioni 1 - rishikimi i ligjit ekzistues nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar**, me qëllim kalimin e varësisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA) nga Kryeministri tek ministria përgjegjëse për kulturën.

Ky opsion është përzgjedhur pasi adreson drejtpërdrejt problematikën e identifikuar në Raportin e SIGMA-s të realizuar në kuadër të programit të OECD për “Forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri”, i cili ka evidentuar nivelin e lartë të centralizimit në administratën qendrore dhe ka rekomanduar reduktimin e numrit të institucioneve që raportojnë drejtpërdrejt te zyra e

Kryeministrit. Në këtë kontekst, raporti ka sugjeruar konkretisht rishikimin e varësisë institucionale të DPA dhe kalimin e tij në varësi të ministrit përgjegjës për sektorin përkatës.

Ndryshimi i ligjit konsiderohet alternativa më e përshtatshme pasi mundëson rregullimin e qartë të varësisë institucionale në nivel ligjor, duke garantuar siguri juridike dhe qartësi në linjat e përgjegjësisë dhe raportimit institucional. Gjithashtu, ky opsion kontribuon në rishpërndarjen më të balancuar të përgjegjësisë në nivel qendror dhe në përmirësimin e koordinimit sektorial.

Nga pikëpamja financiare, ndërhyrja ligjore është e natyrës organizative dhe nuk parashikon ndryshime në funksionet, strukturën organizative, numrin e punonjësve apo buxhetin e institucionit. Për rrjedhojë, **kostoja monetare e këtij opsioni është 0 lekë kosto shtesë** për buxhetin e shtetit dhe nuk krijon detyrime financiare për bizneset apo subjektet e tjera.

Përfitimet kryesore të këtij opsioni lidhen me përmirësimin e organizimit institucional të administratës qendrore, rritjen e koherencës së politikave publike dhe zbatimin e rekomandimeve ndërkombëtare për forcimin e qendrës së qeverisjes. Edhe pse këto përfitime nuk mund të maten drejtpërdrejt në terma monetarë, ato kontribuojnë në rritjen e efikasitetit administrativ dhe në përmirësimin e funksionimit të institucioneve publike.

Nga pikëpamja financiare, ky opsion nuk sjell kosto shtesë për buxhetin e shtetit dhe nuk krijon detyrime për subjektet e tjera, ndërkohë që kontribuon në përmirësimin e organizimit institucional dhe të efikasitetit të qeverisjes. Për këto arsye, ai vlerësohet si alternativa më e përshtatshme për arritjen e objektivave.

Përveç këtyre arsyeve, opsioni 1 konsiderohet më i favorshëm gjithashtu sepse kërkon më pak kohë dhe burime krahasuar me opsionin e riorganizimit më të gjerë institucional (opsioni 2), dhe nuk krijon kostot e larta ose vonesat e opsionit jorregullator (opsioni 3). Ky opsion gjithashtu mundëson realizimin e përfitimeve brenda një periudhe të shkurtër, duke kontribuar në përmirësimin e koordinimit ndër-institucional dhe përputhshmërisë me praktikatat ndërkombëtare të qeverisjes qendrore, siç rekomandohet nga Raporti i SIGMA-s.

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta - te plotësohet nese është kryer konsultimi publik)

Projektligji është hartuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, në vijim të rekomandimeve të marra nga Kryeministria dhe Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Inicimi i hartimit të këtij projektligji erdhi si pasojë e gjetjeve të dala nga Raporti i SIGMA-s i kryer në vitin 2025, lidhur me “Forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri”, ku është rekomanduar një reduktim i numrit të institucioneve në varësi të Kryeministrit, duke bërë edhe sugjerimet konkrete për kalimin e varësisë së këtyre institucioneve. Konkretisht për DPA është sugjeruar të jetë institucion në varësi të ministrit përgjegjës për kulturën, pas konsultimit dhe zhvillimit të takimeve me institucionet përkatëse.

Projektligji është publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike në datë 13.02.2025 me qëllim garantimin e përfshirjes në procesin e konsultimit, të të gjithë aktorëve të interesuar. Procesi i konsultimit publik të projektligjit në RENJKP ka përfunduar më datë 13.03.2026.

Konkretisht, është bërë publikimi në website:

<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/933>

Në Regjistrin Elektronik të Konsultimeve Publike nuk ka patur komente nga publiku. Ky projektakt ka marrë 253 shikime.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Njësia kryesore përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur do të jetë Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, e cila do të marrë në varësi institucionale DPA-në. Kjo ministri do të jetë përgjegjëse për mbikëqyrjen institucionale, koordinimin dhe ndjekjen e zbatimit të funksioneve të DPA në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në procesin e zbatimit do të përfshihet gjithashtu edhe Kryeministria, e cila do të sigurojë koordinimin institucional gjatë fazës së tranzicionit dhe monitorimin e progresit.

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të ndërhyrjes do të realizohet nga MTKS, në bashkëpunim me DPA. Procesi i monitorimit do të konsistojë në ndjekjen periodike të zbatimit të ndryshimit të varësisë institucionale, funksionimit të strukturave administrative dhe nivelit të koordinimit ndërinstitutional.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Fillimet e veprimtarisë arkivore në Shqipëri datojnë që nga antikiteti. Historia dëshmon se në bibliotekat që ekzistojnë në shtetet ilire, në principatat feudale shqiptare, në shtetin e Skënderbeut, në shoqëritë patriotike e kulturore, në institucionet fetare, në firmat tregtare, në esnafët, në familje dhe individë të veçantë, krahas librave ruheshin edhe dokumente.

Në të gjitha aktet ligjore e nënligjore, në vazhdimësi, për krijimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore përfshiheshin detyra edhe për administrimin dhe për ruajtjen e dokumenteve.

Krahas këtyre masave nuk reshtën dhe përpjekjet për krijim e një arkivi Qendror, ku do të përqëndroheshin dokumentet më të rëndësishëm për historinë kombëtare. Dokumenti i parë që ruhet në Arkivin Qendror Shtetëror, që bën fjalë për përpjekjet drejt krijimit të një Arkivi Qendror, është vendimi i datës 02.01.1932 i Këshillit të Naltë të Shtetit, për shqyrtimin e projekt-rregullores, për regjistrimin e ngjarjeve me rëndësi. Në këtë projekt-rregullore, parashikohet edhe krijimi i Arkivit të Përgjithshëm të Shtetit.

Moment i rëndësishëm për historinë e arkivave shqiptare është projekt-ligji i vitit 1932 “Për krijimin e Arkivës së Përgjithshme të Shtetit dhe të Kronikës Historike”, në nenin 1 të të cilit përcaktohet: “Krijohet në kryeqytet një Arkivë e Përgjithshme e Shtetit, për me përmbledh e ruajtë gjithë dokumentet zyrtare”. Megjithatë projekt-ligji nuk u zbatua, ai i dha një nxitje zhvillimit të veprimtarisë arkivore.

Lufta e Dytë Botërore, ngadalësoi nismat e marra nga organet shtetërore për arkivat dhe ata deri në përfundim të saj mbetën në nivelin e sekretari-arkivave, si njësi strukturore të institucioneve, që ndiqnin dhe përgjigjeshin vetëm për administrimin e dokumenteve të tyre. Megjithatë në sajë të veprimtarisë së tyre, u bë e mundur që të ruhen e të trashëgohen sasi të vlerësueshme dokumentesh me shtrirje pothuajse gjithëpërfshirëse subjektsh, kohore, hapsinore dhe në përmbajtje.

Përpjekjet për krijim e një arkivi qendror vazhduan edhe pas Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1947, pranë Institutit të Studimeve u krijua “Arkivi Dokumentar i Institutit”. Ai grumbulloi një sasi të konsiderueshme dokumentesh historikë që ruheshin në organet shtetërore apo individë të veçantë, duke marrë kështu dhe atributet e një Arkivi Qendror, por jo me të gjitha karakteristikat e një organi të tillë.

Arkivi Qendror Shtetëror (AQSH), u krijua si organ Qendror, megjithatë në varësi të Institutit të Studimeve, me urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr 21 datë 08.06.1949. Krijimi i tij shënon një moment kulmor për historinë e arkivave shqiptare.

Për herë të parë, krahas arkivave të organeve shtetërore, filloi funksionimi i një organi të mirëfilltë arkivor me shtrirje gjithëshqiptare. Në vitin 1951, Arkivi Qendror i Shtetit kaloi në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, varësi të cilën e ruajti deri në vitin 1962, kur u krijua Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit (sot Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave), në varësi të Këshillit të Ministrave. Krahas të qenit organ Qendror, kjo Drejtori kishte dhe ka edhe atributet e Arkivit Qendror Shtetëror, si arkivi më i rëndësishëm dhe më i pasur i rrjetit arkivor të vendit.

Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat” përbën kuadrin bazë ligjor për organizimin dhe funksionimin e sistemit arkivor në Shqipëri, duke përcaktuar institucionet arkivore, përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme

të Arkivave dhe rrjetin arkivor, si dhe detyrimet e institucioneve publike dhe private për krijimin, ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve. Ai rregullon gjithashtu mënyrën e ruajtjes dhe shfrytëzimit të pasurisë arkivore, duke mbuluar në tërësi ciklin e jetës së dokumenteve me vlerë arkivore. Qëllimi kryesor i ligjit është mbrojtja dhe administrimi i pasurisë dokumentare kombëtare si pjesë e trashëgimisë kombëtare, garantimi i ruajtjes afatgjatë të dokumenteve me vlerë historike, juridike, administrative dhe kulturore, si dhe sigurimi i aksesit dhe përdorimit të tyre nga publiku dhe institucionet, duke vendosur një ekuilibër ndërmjet ruajtjes së sigurisë dhe integritetit të dokumenteve dhe mundësitit të përdorimit të tyre për qëllime kërkimore, transparente dhe administrative.

Ndryshimi kryesor dhe praktikisht i vetmi i rëndësishëm strukturor në ligjin nr. 9154/2003 është Ligji nr. 27/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 ‘Për arkivat’”, i cili përbën ndërhyrjen më të fundit dhe më të rëndësishme në këtë kuadër ligjor. Ndryshe nga disa ligje sektoriale të tjera, ligji ka qëndruar relativisht i pandryshuar për rreth 20 vite dhe ndërhyrja e vitit 2024 synon modernizimin e sistemit arkivor, duke e përshtatur atë me zhvillimet teknologjike dhe digjitalizimin, përmirësimin e menaxhimit të dokumenteve dhe riorganizimin institucional, duke qartësuar strukturën e rrjetit arkivor dhe forcimin e rolit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Gjithashtu, ndryshimet përfshijnë përmirësimin e procedurave për përzgjedhjen, ruajtjen dhe asgjësimin e dokumenteve, me një kontroll dhe mbikëqyrje më të fortë, si dhe harmonizimin e ligjit me kuadrot e tjera ligjore në fuqi, përfshirë ligjin për informacionin e klasifikuar, ligjin për të drejtën e informimit dhe ligjin për të dhënat personale.

Në kuadër të ligjit aktual janë miratuar disa akte nënligjore si vijon:

VKM nr. 162, datë 19.03.2014 – “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, akt që ka si qëllim organizimin dhe funksionimin w Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave si organi kryesor drejtues i sistemit arkivor në Shqipëri.

VKM nr. 164, datë 19.03.2014 – “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Arkivave”, me qëllim krijimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Arkivave si organ kolegjal që mbikëqyr dhe koordinon politikat arkivore.

VKM nr. 165, datë 19.03.2014 – “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Ekspertizës” Qëllimi: Organizimi i Komisionit Qendror të Ekspertizës, përgjegjës për vlerësimin dhe përzgjedhjen e dokumenteve me vlerë arkivore.

VKM nr. 207, datë 09.04.2014 – “Për përcaktimin e rregullave për administrimin, përzgjedhjen dhe ruajtjen e dokumenteve arkivore”, akt që ka si qëllim vendosjen e rregullave për ruajtjen, përzgjedhjen dhe administrimin e dokumenteve, duke përfshirë asgjësimin e dokumenteve pa vlerë; ky është një nga aktet më të rëndësishme praktike.

VKM nr. 173, datë 23.02.2011 – “Për miratimin e tarifave të shërbimit arkivor” Qëllimi: Miratimi i tarifave për shërbimet që ofrohen nga arkivat, duke përfshirë shërbimet e ruajtjes, kopjimit dhe përdorimit të dokumenteve.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 30.04.2014 – “Për miratimin e normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” Qëllimi: Miratimi i normave tekniko-profesionale dhe metodologjike që udhëheqin gjithë procesin e shërbimit arkivor; ky është akti kryesor teknik për zbatimin e ligjit.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*

- *Identifikoni grupet e prekura nga problemi (qeveria, biznesi, shoqëria civile, qytetarët).*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problematika lidhet me organizimin institucional dhe varësinë administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA), e cila aktualisht është e përcaktuar në ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar”. Sipas këtij ligji, DPA është në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit. Kjo mënyrë organizimi lidhet me disa problematika institucionale që kanë të bëjnë me centralizimin e administratës publike qendrore, shpërndarjen e përgjegjësive ndërmjet institucioneve dhe koherencën e mbikëqyrjes sektoriale.

1. Niveli i lartë i centralizimit të strukturës së administratës qendrore

Struktura aktuale e administratës publike qendrore në Republikën e Shqipërisë karakterizohet nga një nivel relativisht i lartë centralizimi në qendrën e qeverisjes. Një numër i konsiderueshëm autoritetesh dhe agjencish raportojnë drejtpërdrejt pranë Kryeministrit, duke përfshirë edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave (DPA). Në këtë kuadër, edhe DPA është aktualisht në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit, pavarësisht se funksionet dhe veprimtaria e tij lidhen me një fushë specifike sektoriale. Kjo situatë është evidentuar edhe në Raportin e SIGMA-s për “Forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri”, të realizuar në kuadër të programit të OECD.

Sipas gjetjeve të raportit të SIGMA-s, aktualisht rreth 26 autoritete dhe agjenci raportojnë drejtpërdrejt pranë zyrës së Kryeministrit.

Ky nivel i lartë centralizimi mund të krijojë një ngarkesë të konsiderueshme koordinuese dhe mbikëqyrëse për qendrën e qeverisjes, duke e bërë më të vështirë përqendrimin e saj në funksionet kryesore strategjike që zakonisht ushtrohen nga qendrat e qeverisjes në vendet e OECD-së, si koordinimi i politikave qeveritare, planifikimi strategjik dhe monitorimi i zbatimit të programit të qeverisë. Në këtë kuptim, përqendrimi i një numri të madh institucionesh në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit kufizon mundësinë për një shpërndarje më të balancuar të përgjegjësive ndërmjet institucioneve të administratës publike qendrore.

2. Mospërputhja ndërmjet natyrës sektoriale të funksioneve të DPA dhe nivelit të mbikëqyrjes institucionale

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ushtron funksione që lidhen drejtpërdrejt me një fushë sektoriale të specializuar, konkretisht me ruajtjen, përpunimin, administrimin e Fondit Arkivor Kombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Megjithatë, pavarësisht natyrës së specializuar dhe sektoriale të këtyre funksioneve, DPA aktualisht ndodhet në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit dhe jo në varësi të një ministrie përgjegjëse për fushën përkatëse. Kjo krijon një mospërputhje ndërmjet natyrës së funksioneve të institucionit dhe strukturës së mbikëqyrjes institucionale.

Në praktikën ndërkombëtare, institucionet me funksione sektoriale zakonisht vendosen në varësi të ministrive përkatëse për të siguruar koordinim më të drejtpërdrejtë me politikën sektoriale, ndërsa qendra e qeverisjes fokusohet kryesisht në funksione strategjike dhe ndërsektoriale. Organizimi aktual institucional i DPA nuk reflekton plotësisht këtë parim të shpërndarjes funksionale të përgjegjësive.

3. Nevoja për rishpërndarje më të balancuar të përgjegjësive në administratën publike qendrore

Raporti i SIGMA-s për forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri ka theksuar nevojën për një organizim më të balancuar të marrëdhënive institucionale ndërmjet qendrës së qeverisjes dhe institucioneve sektoriale. Në këtë drejtim, praktikën e vendeve të OECD-së tregojnë se një qendër qeverisjeje efektive duhet të fokusohet në funksione strategjike dhe koordinuese, ndërsa funksionet sektoriale duhet të menaxhohen kryesisht nga ministritë përkatëse.

Në këtë kontekst, organizimi aktual institucional i DPA si institucion në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit nuk kontribuon në mënyrë të plotë në realizimin e këtij modeli organizativ. Për këtë arsye, është evidentuar nevoja për rishikimin e varësisë institucionale të këtij autoriteti, me qëllim krijimin e një shpërndarjeje më të balancuar të përgjegjësive ndërmjet qendrës së qeverisjes dhe institucioneve sektoriale.

Kjo nevojë lidhet edhe me procesin më të gjerë të reformës së administratës publike dhe me përpjekjet për të përmirësuar koherencën institucionale, efikasitetin administrativ dhe koordinimin e politikave në përputhje me parimet e administratës publike dhe standardet e Bashkimit Evropian.

Shkaku kryesor i problematikës lidhet me rregullimin aktual ligjor të përcaktuar në ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar”, i cili parashikon që DPA të jetë në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit. Ky konfigurim institucional është përcaktuar në momentin e miratimit të ligjit dhe nuk është rishikuar në mënyrë të plotë në kuadër të reformave të mëvonshme të administratës publike. Ky model organizimi ka sjellë një përqendrim të konsiderueshëm të funksioneve të mbikëqyrjes dhe raportimit në nivelin e Kryeministrit.

Në të njëjtën kohë, mungesa e një rishikimi sistematik të varësisë institucionale të autoriteteve dhe agjencive në raport me funksionet sektoriale që ato kryejnë ka bërë që disa institucione, përfshirë DPA, të mbeten të vendosura në një strukturë organizative që nuk pasqyron plotësisht natyrën e funksioneve të tyre.

Organizimi aktual institucional mund të ketë disa pasoja në funksionimin e administratës publike qendrore dhe në koordinimin institucional.

Së pari, ai kontribuon në një ngarkesë më të madhe administrative dhe koordinuese për qendrën e qeverisjes, duke rritur numrin e institucioneve që raportojnë drejtpërdrejt pranë Kryeministrit.

Së dyti, mbikëqyrja institucionale e një autoriteti sektorial nga qendra e qeverisjes mund të kufizojë potencialin për një koordinim më të drejtpërdrejtë me politikat sektoriale dhe me institucionet që operojnë në të njëjtën fushë.

Së treti, një strukturë e tillë organizative mund të ndikojë në efikasitetin e përgjithshëm të shpërndarjes së përgjegjësive në administratën publike qendrore, duke mos reflektuar plotësisht parimet e delegimit të funksioneve dhe të koordinimit ndërinstitucional që promovohen në kuadër të reformës së administratës publike dhe procesit të integritimit evropian.

Problemi kryesisht ka natyrë rregullatore, pasi lidhet drejtpërdrejt me dispozitat e përcaktuara në kuadrin ligjor ekzistues, konkretisht në ligjin nr. 9154/2003, të ndryshuar, i cili përcakton varësinë institucionale të DPA.

Në të njëjtën kohë, problematika ka edhe karakter institucional dhe organizativ, pasi lidhet me mënyrën e organizimit dhe funksionimit të administratës publike në nivel qendror. Ai ndikon në mënyrën e raportimit dhe mbikëqyrjes institucionale të DPA dhe në shpërndarjen e përgjegjësive ndërmjet institucioneve të qeverisjes qendrore.

Grupet kryesore të prekura nga problematika janë:

- institucionet e administratës shtetërore qendrore, veçanërisht Kryeministria dhe ministritë përgjegjëse për fushën përkatëse;
- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA);
- Rrjeti arkivor i Republikës së Shqipërisë;
- aktorë të tjerë;

1. Kryeministria

Aktualisht mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë mbikëqyrëse për një numër të madh autoritetesh dhe agjencish, përfshirë DPA. Centralizimi i raportimit mund të rrisë ngarkesën institucionale dhe administrative për qendrën e qeverisjes.

2. Ministria përgjegjëse për fushën përkatëse

Në mungesë të një varësie institucionale të drejtpërdrejtë të DPA, koordinimi sektorial mund të realizohet në mënyrë më të tërthortë, duke kufizuar potencialin për integrimin e plotë të politikave që lidhen me informacionin gjeohapësinor.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA)

Institucioni ndikohet drejtpërdrejt nga struktura e raportimit dhe mbikëqyrjes institucionale, e cila mund të ndikojë në mënyrën e koordinimit të tij me institucionet sektoriale dhe në integrimin e funksioneve të tij në politikën përkatëse.

4. Rrjeti arkivor i Republikës së Shqipërisë;

Këto institucione bashkëpunojnë me DPA në kuadër të ruajtjes së Fondit Arkivor të Republikës së Shqipërisë dhe mund të ndikohen nga mënyra se si organizohet dhe koordinohet institucionalisht autoriteti përgjegjës.

5. Aktorë të tjerë, përfshirë sektorin privat, institucionet akademike dhe përdoruesit e të dhënave arkivore

Këta aktorë janë përdorues të të dhënave dhe shërbimeve arkivore dhe ndikohen në mënyrë të tërthortë nga mënyra se si organizohet dhe funksionon sistemi institucional i koordinimit të këtyre të dhënave.

Problemi mund të trajtohet nëpërmjet ndërhyrjes së qeverisë, për të mundësuar rishikimin e varësisë institucionale të DPA. Kjo ndërhyrje do të mundësojë rishpërndarjen më të balancuar të përgjegjësive në nivel qendror, në përputhje me rekomandimet e Raportit të SIGMA-s dhe me objektivat e reformës së administratës publike.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Qeveria planifikon të ndërhyjë në vijim të gjetjeve dhe rekomandimeve të Raportit të SIGMA-s për “Forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri”, i realizuar në kuadër të programit të OECD. Raporti ka evidentuar se struktura administrative në Shqipëri mbetet shumë e centralizuar, me një numër të konsiderueshëm autoritetesh dhe agjencish që raportojnë drejtpërdrejt te zyra e Kryeministrit. Ky konfigurim institucional krijon një përqendrim të lartë të funksioneve të mbikëqyrjes dhe raportimit në qendrën e qeverisjes, duke e bërë më të vështirë fokusimin e saj në funksionet kryesore strategjike të koordinimit të politikave qeveritare, planifikimit strategjik dhe monitorimit të zbatimit të programit të qeverisë. Në këtë kuadër, është vlerësuar e nevojshme rishpërndarja e përgjegjësive institucionale për të reduktuar centralizimin dhe për të përmirësuar efektivitetin e qeverisjes.

Përmes kësaj ndërhyrjeje synohet të rishikohet varësia institucionale e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA), duke kaluar këtë institucion nga varësia e Kryeministrit në varësi të ministrit përgjegjës për kulturën. Ky ndryshim synon të sigurojë përputhje më të plotë ndërmjet funksioneve të institucionit dhe mbikëqyrjes sektoriale, si dhe të përmirësojë koordinimin institucional në fushën e arkivave.

Ndërhyrja e qeverisë është e kufizuar duke konsistuar vetëm në ndryshimin e varësisë institucionale të DPA. Kjo ndërhyrje nuk prek funksionet, kompetencat, strukturën organizative apo buxhetin e institucionit.

Sa më sipër, ky ndryshim synon të trajtojë disa çështje kryesore që lidhen me organizimin institucional të administratës publike:

- reduktimin e nivelit të centralizimit në qendrën e qeverisjes, duke rishpërndarë përgjegjësitë institucionale në mënyrë më të balancuar;
- sigurimin e një përputhjeje më të plotë ndërmjet natyrës sektoriale të funksioneve të DPA dhe institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen e tij;
- përmirësimin e koordinimit institucional në fushën e arkivave dhe integrimin më të mirë të politikave sektoriale në këtë fushë;
- rritjen e efikasitetit të organizimit të administratës publike qendrore nëpërmjet një strukture më funksionale të raportimit dhe mbikëqyrjes institucionale.

Kjo ndërhyrje mbështet objektivat e qeverisë për forcimin e qendrës së qeverisjes, përmirësimin e organizimit të administratës publike dhe rritjen e efikasitetit institucional. Gjithashtu, ajo kontribuon në zbatimin e reformës së administratës publike dhe në përafrimin me praktikat ndërkombëtare të organizimit të administratës, në kuadër të procesit të integritit evropian, të cilat promovojnë një ndarje më të qartë të përgjegjësisve ndërmjet funksioneve strategjike të qendrës së qeverisjes dhe funksioneve sektoriale të ministrive. Në këtë mënyrë, ndërhyrja mbështet edhe procesin e integritit evropian të Shqipërisë, duke kontribuar në përmirësimin e efektivitetit të qeverisjes dhe koherencës institucionale.

Analiza dhe identifikimi i problematikës janë mbështetur gjithashtu në gjetjet e Raportit të SIGMA-s për “Forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri”, i cili ka kryer një vlerësim të situatës aktuale dhe ka dhënë rekomandime konkrete për rishpërndarjen e përgjegjësisve në nivel qendror. Në vijim të këtyre rekomandimeve është theksuar rëndësia e një organizimi institucional që mundëson fokusimin e qendrës së qeverisjes në funksionet strategjike të koordinimit dhe monitorimit të politikave qeveritare.

Puna ekzistuese e realizuar nga administrata për adresimin e problematikës:

Administrata publike ka ndërmarrë një sërë hapash analitikë dhe koordinues për të vlerësuar organizimin aktual institucional dhe për të adresuar çështjet që lidhen me funksionimin e qendrës së qeverisjes dhe shpërndarjen e përgjegjësisve ndërmjet institucioneve të administratës publike qendrore.

Në këtë kuadër, një nga hapat kryesorë ka qenë realizimi i një vlerësimi të thelluar të strukturës dhe funksionimit të qendrës së qeverisjes në Shqipëri nëpërmjet Raportit të SIGMA-s për “Forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri”, i realizuar në kuadër të programit të OECD. Ky raport ka analizuar mënyrën e organizimit të institucioneve që raportojnë pranë qendrës së qeverisjes, duke e krahasuar atë me praktikën e vendeve të OECD-së dhe duke identifikuar nivelet e centralizimit institucional në administratën publike shqiptare.

Në vijim të këtij vlerësimi, administrata publike ka zhvilluar analiza të brendshme dhe diskutime institucionale për mënyrën e organizimit dhe mbikëqyrjes së disa autoriteteve dhe agjencive që aktualisht raportojnë drejtpërdrejt pranë Kryeministrit, me qëllim identifikimin e mundësive për një shpërndarje më të balancuar të përgjegjësisë institucionale.

Gjithashtu, në praktikë është siguruar koordinimi ndërinstitucional për funksionimin e sistemit të informacionit gjeohapësinor përmes mekanizmave administrativë dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që prodhojnë dhe përdorin të dhëna arkivore. Megjithatë, këto mekanizma koordinimi nuk adresojnë plotësisht çështjen e organizimit institucional dhe të varësisë administrative të autoritetit përgjegjës për këtë fushë.

Si rezultat i analizave të kryera dhe rekomandimeve të dhëna nga Raporti i SIGMA-s, është arritur në përfundimin se adresimi i plotë i problematikës që lidhet me nivelin e centralizimit dhe me përputhjen ndërmjet funksioneve sektoriale dhe mbikëqyrjes institucionale.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivi kryesor i ndërhyrjes është:

1. Përmirësimi i organizimit institucional të administratës publike qendrore, nëpërmjet rishikimit të varësisë institucionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA), brenda vitit 2026.

Ky objektivi synon të adresojë nivelin e lartë të centralizimit të institucioneve në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit dhe të kontribuojë në rishpërndarjen më të balancuar të përgjegjësisë në nivel qendror, në përputhje me rekomandimet e Raportit të SIGMA-s të realizuar në kuadër të programit të OECD.

Objektivi është specifik pasi lidhet drejtpërdrejt me ndryshimin e varësisë institucionale të DPA. Ai është i matshëm, i arritshëm dhe realist, pasi ndërhyrja është e kufizuar dhe e natyrës organizative, pa kërkuar ndryshime në strukturën apo buxhetin e institucionit.

2. Ulja e nivelit të centralizimit të institucioneve që raportojnë drejtpërdrejt pranë Kryeministrit, nëpërmjet rishpërndarjes më të balancuar të përgjegjësisë institucionale në administratën publike qendrore, brenda vitit 2026;
3. Sigurimi i përputhjes ndërmjet funksioneve sektoriale të DPA dhe mbikëqyrjes së tij institucionale, nëpërmjet vendosjes së këtij institucioni në varësi të ministrisë përgjegjëse për fushën përkatëse;
4. Forcimi i koordinimit ndërinstitucional dhe integritit të politikave në fushën e arkivave, nëpërmjet vendosjes së DPA nën mbikëqyrjen e ministrisë përgjegjëse për këtë fushë;
5. Përbushja e rekomandimeve të Raportit të SIGMA-s, duke forcuar koordinimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë institucionale të DPA dhe duke përmirësuar efektivitetin e raportimit dhe mbikëqyrjes sektoriale brenda vitit 2026.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Në kuadër të trajtimit të problematikës së identifikuar janë marrë në konsideratë opsionet e mëposhtme të politikave:

- **Opsioni 0 – Status quo:** ruajtja e situatës aktuale pa ndërhyrje në kuadrin ligjor, duke mbajtur DPA në varësi të Kryeministrit.
- **Opsioni 1 – Ndryshimi i ligjit (opsioni i preferuar):** ndërhyrja në ligjin nr.9154/2003, të ndryshuar, për të mundësuar kalimin e varësisë institucionale të DPA nga Kryeministri tek ministri përgjegjës për Kulturën. Ky opsion synon të adresojë rekomandimin e Raportit të SIGMA-s dhe të kontribuojë në rishpërndarjen më të balancuar të përgjegjësiave në nivel qendror.
- **Opsioni 2 – Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri.** Rishikimi më i thelluar i kuadrit ligjor dhe institucional që mund të përfshijë ndryshime më të gjera në strukturën ose funksionet e DPA. Ky opsion do të kërkonte analiza më të thelluara institucionale dhe ndryshime më të gjera ligjore.
- **Opsioni 3- Jorregullator**

Opsioni i status quo-së konsiston në mosndryshimin e kuadrit ligjor ekzistues, duke vijuar me organizimin aktual të përcaktuar në ligjin nr.9154/2003, të ndryshuar, sipas të cilit DPA mbetet në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit. Ky opsion nuk kërkon ndërhyrje ligjore apo ndryshime në organizimin institucional ekzistues, por njëkohësisht nuk adreson gjetjet dhe rekomandimet e Raportit të SIGMA-s për “Forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri”, të realizuar në kuadër të programit të OECD, i cili ka rekomanduar reduktimin e numrit të institucioneve që raportojnë drejtpërdrejt te zyra e Kryeministrit. Ky opsion ka avantazhin se nuk kërkon procedura ligjore ose ndryshime administrative, duke ruajtur stabilitetin e menjëhershëm dhe duke shmangur shpenzime ose përpjekje shtesë. Gjithashtu, ai mund të konsiderohet si një zgjidhje e sigurt përse i përket zbatimit të procedurave ekzistuese dhe evitimit të komplikimeve ligjore. Megjithatë, ky opsion nuk adreson problematikën kryesore të identifikuar, e cila lidhet me nivelin e lartë të centralizimit dhe me mungesën e përputhjes ndërmjet funksioneve sektoriale të DPA dhe mbikëqyrjes së tij institucionale. Mungesa e ndërhyrjes mund të vazhdojë të pengojë koordinimin institucional, të kufizojë efektivitetin e administratës publike qendrore dhe të mos përmbushë rekomandimet e Raportit të SIGMA-s.

Opsioni 1, ndryshimi i ligjit nr. 9154/2003, është opsioni i preferuar dhe parashikon kalimin e varësisë institucionale të DPA nga Kryeministri tek ministri përgjegjës për fushën përkatëse. Ky opsion ka avantazhin kryesor të adresimit të drejtpërdrejtë të problematikës identifikuese, duke përmirësuar koordinimin institucional, duke rritur përputhshmërinë ndërmjet funksioneve sektoriale dhe mbikëqyrjes, si dhe duke kontribuar në rishpërndarjen më të balancuar të përgjegjësiave në administratën qendrore. Ai gjithashtu përputhet me rekomandimet e Raportit të SIGMA-s dhe mbështet objektivat e reformës së administratës publike dhe forcimit të qendrës së qeverisjes. Përveç këtyre, ky opsion ka më pak kosto krahasuar me opsionin 2, kërkon më pak kohë dhe burime, dhe duke qenë se ndërhyrjet në varësinë institucionale, në kuadër të teknikës legjislativë, nuk preket më shumë se 50% e dispozitave të ligjit, duke e bërë atë zgjidhjen më të përshtatshme dhe efikase.

Opsioni 2, riorganizim më i gjerë institucional, parashikon hartimin dhe miratimin e një ligji të ri, që do të përfshinte rishikim më të thelluar të kuadrit ligjor dhe institucional dhe ndryshime më të gjera në strukturën ose funksionet e DPA. Avantazhi i këtij opsioni qëndron në mundësinë për të adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse problematikën e identifikuar, përfshirë çdo çështje organizative ose funksionale që mund të ndikojë në efektivitetin e qeverisjes dhe koordinimin institucional. Ai gjithashtu mund të sjellë një strukturë më të qëndrueshme dhe të integruar të administratës publike, në përputhje me praktikën ndërkombëtare. Megjithatë, disavantazhet janë të konsiderueshme: ky opsion kërkon kohë të gjatë për analiza institucionale, konsultime dhe procedura ligjore komplekse, shpenzime të mëdha administrative dhe

rrizikon e vonesave ose bllokimeve gjatë miratimit. Ai gjithashtu mund të sjellë paqartësi gjatë fazës së tranzicionit dhe nevojën për burime të shtuar për menaxhimin e ndryshimeve.

Opsioni 3, jorregullator, konsiston në zbatimin e masave jo-ligjore për përmirësimin e situatës, si mekanizma koordinimi administrativ, rritje e bashkëpunimit ndërinstitucional, udhëzime ose protokolle për raportimin dhe mbikëqyrjen e DPA. Avantazhi i këtij opsioni është se mund të zbatohet pa ndërhyrje ligjore, duke u fokusuar në përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Megjithatë, ky opsion ka disavantazhin se kërkon shumë kohë dhe burime për të pasur efekt, nuk adreson rrënjësisht problematikën e centralizimit dhe të varësisë institucionale të DPA, dhe nuk garanton përputhjen e plotë me rekomandimet e SIGMA-s, duke lënë të paprekur sfidat strukturore dhe institucionale që ndikojnë në efektivitetin e administratës publike qendrore.

Opsionet e mësipërme janë përzgjedhur duke marrë në konsideratë natyrën e problematikës së identifikuar, rekomandimet e Raportit të SIGMA-s dhe nevojën për një ndërhyrje proporcionale në kuadrin ligjor. Në këtë kuadër, është vlerësuar se ndërhyrja e kufizuar në ligjin nr.9154/2003 për ndryshimin e varësisë institucionale të DPA përbën alternativën më të përshtatshme, pasi adreson drejtpërdrejt problematikën e centralizimit institucional, pa kërkuar riorganizime të thella strukturore apo implikime financiare shtesë.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Grupet e prekura nga ndërhyrja janë: Kryeministria, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, institucionet publike që bashkëpunojnë me DPA në kuadër të ruajtjes së fondit arkivor, si dhe në mënyrë të tërthortë bizneset dhe përdoruesit e të dhënave arkivore.

Vlerësimi i opsioneve dhe analizimi i ndikimeve

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA)

Ndikimet sociale:

- Përmirësim i qartë i mbikëqyrjes dhe raportimit institucional.
- Rritje e koordinimit me institucionin përgjegjës sektorial, gjë që mund të përmirësojë menaxhimin e burimeve dhe planifikimin e projekteve.

Ndikimet ekonomike:

- Nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë ekonomik, pasi nuk ndryshojnë strukturat, kompetencat apo buxheti i institucionit.
- Ndikimet indirekte mund të lidhen me përdorimin më efikas të të dhënave gjeohapësinore në projekte zhvillimore.

Ndikimet financiare:

- Nuk ka kosto financiare të drejtpërdrejta, sepse ndërhyrja është e kufizuar në nivel ligjor dhe nuk kërkon shtesa buxhetore.

2. Ministria përgjegjëse për fushën përkatëse

Ndikimet sociale:

- Përmirësim i kapacitetit për mbikëqyrje dhe koordinim të DPA.
- Përmirësim i qartë i transparencës dhe përgjegjësisë sektoriale.

Ndikimet ekonomike:

- Nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë ekonomik, por mund të ndikojë indirekt në përmirësimin e menaxhimit të projekteve që përdorin të dhëna arkivore.

Ndikimet financiare:

- Nuk ka kosto të drejtpërdrejta financiare për ministrinë, pasi nuk kërkohen burime shtesë për funksionimin e mbikëqyrjes.

3. Kryeministria

Ndikimet sociale:

- Reduktim i ngarkesës së koordinimit të institucioneve që raportojnë drejtpërdrejt te Kryeministri.
- Përmirësim i fokusit të Kryeministrit mbi çështje strategjike dhe politikat qeveritare më të gjera.

Ndikimet ekonomike:

- Nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë ekonomik.

Ndikimet financiare:

- Nuk ka kosto financiare të drejtpërdrejta.

4. Institucionet dhe aktorët publikë që përdorin të dhëna arkivore

Ndikimet sociale:

- Përmirësim i qartë i koordinimit me DPA dhe aksesit në të dhëna.
- Rritje e efikasitetit në marrjen e vendimeve bazuar në të dhëna të sakta dhe të përditësuara.

Ndikimet ekonomike:

- Ndikime të drejtpërdrejta të kufizuara.
- Përfitime indirekte nga përdorimi më i mirë i të dhënave në projekte dhe shërbime.

Ndikimet financiare:

- Nuk ka kosto financiare të drejtpërdrejtë.

Nga ana cilësore, ndryshimi i propozuar sjell qartësi në linjat e raportimit dhe mbikëqyrjes institucionale dhe kontribuon në rishpërndarjen më të balancuar të përgjegjësi në nivel qendror, në përputhje me rekomandimet e Raportit të SIGMA-s të realizuar në kuadër të programit të OECD. Nga ana sasiore, ndërhyrja nuk sjell ndryshime në strukturën organizative, numrin e punonjësve apo buxhetin e institucionit. **Kostoja monetare e drejtpërdrejtë vlerësohet 0 lekë**, pasi ndryshimi është vetëm organizativ.

Ndikimi mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme është neutral, pasi projektligji nuk krijon detyrime të reja administrative apo financiare për bizneset. Nga ana cilësore, pritet përmirësim i koordinimit ndër-institucional dhe rritje e efikasitetit në organizimin e administratës qendrore. Nuk priten ndikime në konkurrencë, pasi ndërhyrja nuk rregullon aktivitet ekonomik apo tregtar.

Ndikimet afatshkurtra dhe afatgjata

Në afat të shkurtër, ndikimet lidhen me përshtatjen e praktikave të raportimit dhe rritjen e bashkëpunimit ndër-institucional. Në afat të gjatë, ndërhyrja pritet të rrisë efikasitetin e qeverisjes qendrore, përmirësojë koordinimin midis institucioneve dhe të mbështesë zbatimin e politikave publike në mënyrë më efektive.

Analiza bazohet në supozimin se ndryshimi i varësisë institucionale nuk shoqërohet me ndryshime strukturore apo buxhetore. Provat mbështeten në gjetjet dhe rekomandimet e raportit të SIGMA-s. Rreziku kryesor lidhet me nevojën për përshtatje administrative gjatë fazës fillestare të zbatimit.

Kufizimet e analizës

Supozimet: Ndikimet janë vlerësuar duke supozuar se ndryshimi i varësisë institucionale nuk do të ndikojë në strukturën, buxhetin ose kompetencat e DPA.

Rëndësia e provave: Supozimet mbështeten nga Raporti i SIGMA-s, analiza e strukturës ekzistuese administrative dhe përvojat ndërkombëtare në qeverisje qendrore.

Rreziqet dhe pengesat: Realizimi i përfitimeve mund të pengohet nga mungesa e implementimit të praktikave të reja të raportimit, koordinimit të dobët ndër-institucional ose ngërçe burokratike gjatë fazës së tranzicionit. Ndërkohë, ndryshimet e kufizuara ligjore nuk përjashtojnë rrezikun e pasoja të papritura në menaxhimin operacional, të cilat mund të kërkojnë zgjidhje shtesë.

Përmbledhje e vlerësimit të opsioneve

- **Opsioni 0 (status quo):** nuk adreson rekomandimet për reduktimin e centralizimit.
- **Opsioni 1 (opsioni i preferuar):** ndryshimi i ligjit për kalimin e varësisë së DPA tek Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit; ndikim institucional pozitiv dhe **kosto monetare 0 lekë**.
- **Opsionet e tjera:** do të kërkonin riorganizim më të gjerë institucional dhe analiza shtesë.

Në përfundim, **opsioni 1 paraqet ndikimin më pozitiv institucional me kosto financiare 0**, duke e bërë atë alternativën më të përshtatshme për zgjidhjen e problemit.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Bazuar në analizën e opsioneve të shqyrtuara, opsioni i preferuar është **opsioni 1**, i cili parashikon ndryshimin e ligjit nr.9154/2003, të ndryshuar, për të mundësuar kalimin e varësisë institucionale të DPA nga Kryeministri tek MTKS.

Ky opsion është zgjedhur pasi adreson drejtpërdrejt problematikën e identifikuar lidhur me nivelin e lartë të centralizimit të institucioneve në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit dhe reflekton rekomandimet e Raportit të SIGMA-s për “Forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri”, të realizuar në kuadër të programit të OECD.

Ndërhyrja përmes ndryshimit të kuadrit ligjor mundëson rishpërndarjen më të balancuar të përgjegjësiave në nivel qendror, duke krijuar një përputhje më të qartë ndërmjet funksioneve të institucionit dhe mbikëqyrjes sektoriale. Gjithashtu, ky opsion konsiderohet proporcional dhe i realizueshëm, pasi ndërhyrja është e kufizuar vetëm në ndryshimin e varësisë institucionale dhe nuk kërkon ndryshime në strukturën organizative, në numrin e punonjësve apo në buxhetin e institucionit.

Nga pikëpamja financiare, ky opsion nuk sjell kosto shtesë për buxhetin e shtetit dhe nuk krijon detyrime për bizneset apo subjektet e tjera, ndërkohë që kontribuon në përmirësimin e organizimit institucional dhe të efikasitetit të qeverisjes. Për këto arsye, ai vlerësohet si alternativa më e përshtatshme për arritjen e objektivave.

Përveç këtyre arsyeve, opsioni 1 konsiderohet më i favorshëm gjithashtu sepse kërkon më pak kohë dhe burime krahasuar me opsionin e riorganizimit më të gjerë institucional (opsioni 2), dhe nuk krijon kostot e larta ose vonesat e opsionit jorregullator (opsioni 3). Ky opsion gjithashtu mundëson realizimin e përfitimeve brenda një periudhe të shkurtër, duke kontribuar në përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional dhe përputhshmërisë me praktikatat ndërkombëtare të qeverisjes qendrore, siç rekomandohet nga Raporti i SIGMA-s.

Përveç argumenteve të përmendura, më poshtë është kryer analiza me shumë kritere, e cila përfshin një analizë më të detajuar mbi opsionet, duke marrë parasysh kritere të ndryshme sociale, ekonomike, financiare dhe efektivitetin e zbatimit, për të arsyetuar më qartë përzgjedhjen e opsionit të preferuar.

Në kuadër të arsyetimit të opsionit të preferuar, është kryer një analizë me shumë kritere për të vlerësuar opsionet e mundshme, duke marrë parasysh pesha të ndryshme për secilin kriter.

Përcaktimi i kritereve për të reflektuar performancën në përmbushjen e objektivave dhe vendosja e peshës së kritereve sipas rëndësisë relative:

Kriteret e përdorura dhe pesha (1–5):

1. Efikasiteti institucional në përmirësimin e koordinimit, raportimit dhe organizimit të institucioneve qendrore. (pesha: 5)

Mat sa opsioni kontribuon në përmirësimin e koordinimit, raportimit dhe organizimit të institucioneve qendrore.

Vlerësimi: 1 = shumë pak efekt, 5 = efekt maksimal.

2. Përputhshmëria me rekomandimet ndërkombëtare dhe Raportin SIGMA (pesha: 4)

Mat sa opsioni përputhet me praktikat ndërkombëtare të qeverisjes qendrore dhe rekomandimet e SIGMA-s.

Vlerësimi: 1 = jo përputhës, 5 = plotësisht përputhës.

3. Koha e zbatimit (pesha: 3)

Mat sa shpejt mund të realizohet opsioni dhe të shfaqen rezultatet e pritshme.

Vlerësimi: 1 = shumë vonë, 5 = menjëherë/afati i shkurtër.

4. Efikasiteti i zbatimit (pesha: 3)

Ky kriter vlerëson sa mirë dhe në mënyrë efektive opsioni mund të prodhojë rezultatet e pritura, duke siguruar që objektivat e projektligjit të arrijnë ndikimin e dëshiruar në praktikë. Ai mat aftësinë e opsionit për të përmirësuar koordinimin ndër-institucional, për të rritur koherencën e politikave dhe për të siguruar përfitime të matshme për grupet e prekura, pa krijuar pengesa të panevojshme. Kjo përfshin kapacitetin e institucioneve për të zbatuar ndryshimet, qartësinë e përgjegjësive dhe integrimin e praktikave të reja në rutinën e tyre operacionale.

Vlerësimi: 1 = rezultat minimal, implementim joefektiv dhe i vështirë; 5 = rezultat maksimal, implementim i lehtë dhe i efektshëm me përfitime të dukshme.

5. Kosto-efektiviteti (pesha: 5)

Mat raportin mes ndikimit të opsionit dhe burimeve të nevojshme (kohë, staf, buxhet).

Vlerësimi: 1 = kosto shumë e lartë për efekt minimal, 5 = efekt maksimal me kosto minimale.

2. Përcaktimi i shkallës së performancës nëpërmjet intervalit të pikëve nga 0-5.

3. Vendosja e pikëve të opsioneve përkundrejt secilit kriter sipas matricës së mëposhtme.

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Efikasiteti institucional në përmirësimin e koordinimit, raportimit dhe organizimit të institucioneve qendrore.	5	1 (5)	5 (25)	5 (25)	2 (10)
Përputhshmëria me rekomandimet ndërkombëtare dhe Raportin SIGMA.	4	0 (0)	4 (16)	4 (16)	0 (0)
Koha e zbatimit.	3	1 (3)	3 (9)	2 (6)	1 (3)
Efikasiteti i zbatimit.	3	0 (0)	3 (9)	2 (6)	1 (3)
Kosto - efektiviteti	5	1 (5)	5 (25)	4 (20)	2 (10)
Pikët		23	84	73	26

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Njësia kryesore përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur do të jetë Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, e cila do të marrë në varësi institucionale DPA. Kjo ministri do të jetë përgjegjëse për mbikëqyrjen institucionale, koordinimin dhe ndjekjen e zbatimit të funksioneve të DPA në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në procesin e zbatimit do të përfshihet gjithashtu edhe Kryeministria e Shqipërisë, e cila do të sigurojë koordinimin institucional gjatë fazës së tranzicionit dhe monitorimin e progresit.

Pengesat e mundshme lidhen kryesisht me aspektet administrative dhe organizative gjatë fazës fillestare të transferimit të varësisë institucionale. Mund të paraqiten sfida në koordinimin ndër-institucional, në përshtatjen e procedurave të raportimit dhe në harmonizimin e dokumenteve administrative ekzistuese. Gjithashtu, mund të kërkohej një periudhë e shkurtër tranzicioni për përshtatjen e proceseve të brendshme të punës dhe të komunikimit institucional.

Gjatë zbatimit do të ndërmerren masa administrative dhe organizative për të siguruar një tranzicion të rregullt dhe efektiv. Këto masa përfshijnë: përcaktimin e qartë të linjave të raportimit institucional, përditësimin e akteve të brendshme administrative, koordinimin ndërmjet institucioneve të përfshira dhe informimin e strukturave përkatëse për ndryshimet e reja. Gjithashtu, do të sigurohet vazhdimësia e funksioneve dhe aktiviteteve të DPA pa ndërprerje gjatë procesit të transferimit të varësisë.

Zbatimi i opsionit të zgjedhur kërkon përputhshmëri me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi që rregullon organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Institucionet përkatëse do të duhet të harmonizojnë aktet e tyre administrative dhe rregulloret e brendshme me ndryshimet e reja ligjore. Për më tepër, do të sigurohet që procesi i zbatimit të jetë në përputhje me parimet e transparencës, koordinimit institucional dhe efikasitetit në administratën publike.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të ndërhyrjes do të realizohet nga MTKS, në bashkëpunim me DPA. Prosesi i monitorimit do të konsistojë në ndjekjen periodike të zbatimit të ndryshimit të varësisë institucionale, funksionimit të strukturave administrative dhe nivelit të koordinimit ndër-institucional. Vlerësimi do të bëhet përmes analizës së performancës institucionale dhe të efikasitetit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që përdorin dhe menaxhojnë informacionin arkivor. Gjithashtu, do të shqyrtohet nëse ndërhyrja ka kontribuar në përmirësimin e organizimit institucional dhe në zbatimin më efektiv të politikave publike në këtë fushë.

Për të matur progresin dhe arritjen e qëllimeve të politikës do të përdoren disa tregues kryesorë, si: funksionimi i rregullt institucional i DPA pas kalimit në varësi të MTKS; niveli i koordinimit ndërmjet institucioneve pjesëmarrëse në infrastrukturën kombëtare të arkivave; respektimi i procedurave të raportimit dhe mbikëqyrjes institucionale; si dhe vazhdimësia dhe efikasiteti i shërbimeve dhe aktiviteteve të lidhura me menaxhimin dhe shpërndarjen e të dhënave arkivore. Këta tregues do të ndihmojnë në vlerësimin e efektivitetit të ndërhyrjes dhe në identifikimin e nevojës për masa të mëtejshme përmirësuese.

Indikatorë të matshëm për monitorim dhe vlerësim:

1. **Koha e implementimit të varësisë së re institucionale**
 - Mat se sa kohë ka marrë kalimi i DPA në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit;
 - Një tregues mund të jetë përqindja e përfundimit të fazave të tranzicionit sipas kalendarit të përcaktuar.
2. **Funksionimi i rregullt institucional i DPA**
 - Numri i rasteve ku DPA ka funksionuar pa ndërprerje pas ndryshimit të varësisë.
 - Matet si përqindje e ditëve të punës ku nuk ka ndërprerje në shërbime dhe raportim.
3. **Niveli i koordinimit ndërinstytucional**
 - Numri i takimeve koordinuese të zhvilluara midis DPA, ministrisë përgjegjëse dhe institucioneve pjesëmarrëse.
 - Përqindja e vendimeve të marrë në këto takime që janë zbatuar në praktikë.
4. **Respektimi i procedurave të raportimit dhe mbikëqyrjes institucionale**
 - Numri i raporteve mujore ose tremujore të dorëzuara sipas afateve të përcaktuara.
 - Përqindja e dokumenteve administrative të përditësuara sipas linjave të raportimit të reja.
5. **Vazhdimësia dhe efikasiteti i shërbimeve**
 - Numri i incidenteve apo ndërprerjeve në shërbimet e rrjetit arkivor pas ndryshimit të varësisë.
 - Koha mesatare e përgjigjes ndaj kërkesave për të dhëna nga institucionet e përfshira.
6. **Përputhshmëria me objektivat strategjike**
 - Matet përmes një vlerësimi cilësor të përfitimeve të arritura për koordinimin institucional dhe përmirësimin e organizimit administrativ.
 - Përqindja e rekomandimeve të SIGMA-s të implementuara në praktikë.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

(Në milion lekë)

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës	1	0.9	0.8	0.7	0.6	0.5	0.4	0.3	0.2	0.1
Kosto për buxhetin – njëhere										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										

Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			

Shkurtesa	Emërtimi & Përshkrimi
DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave